



21 Korrik 2014, Prishtinë

KOMUNIKATË PËR MEDIA

As këtë vit nuk përfundon restaurimi i Xhamisë së Çarshisë në Prishtinë

Në kuadër të projektit “Transparency Online”, EC Ma Ndryshe gjatë muajve qershor-korrik ka filluar një hulumtim rreth punëve konservuese dhe restauruese në objektet e trashëgimisë kulturore në Prishtinë. Fillimisht në fokus të këtij hulumtimi është Xhamia e Çarshisë.

Projekti i konservimit dhe restaurimit të Xhamisë së Çarshisë filloi në vitin 2011, pas nënshkrimit të një marrëveshje në mes të Komunës së Prishtinës si donatore e projektit dhe Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës (IMMK) si punëkryese. Në bazë të marrëveshjes, për realizimin e fazës së parë, Komuna e Prishtinës ka dhënë 80.000 euro; për realizimin e fazës së dytë 250.000 euro; në fazën e tretë ka dhënë 100.000 euro për përfundimin e projektit; dhe në fazën e katërt 132.000 euro për punët për përfundim të tërësishëm të projektit të cilat nuk janë paraparë në fazën përfundimtare. Rrjedhimisht, shuma totale e ndarë deri më tani nga Komuna është 562.000 euro.

Që nga viti 2011 deri në vitin 2013 është kryer një pjesë e punimeve, mirëpo me vonesa të theksuara, për shkak të pagesave jo të rregullta nga ana e Komunës, siç thotë IMMK. Edhe pse punimet ishin paraparë të përfundojnë në vitin 2013, ato nuk kanë përfunduar ende. Sipas IMMK-së, për përfundimin e tërësishëm të projektit nevojiten edhe rreth 95.000 euro, meqë Komuna nuk ka llogaritur koston e projektit, por vetëm koston e punimeve. Për këtë, IMMK ka bërë kërkesë në Komunë, mirëpo në buxhetin e vitit 2014 Komuna e Prishtinës nuk ka paraparë ndonjë shumë për Xhaminë e Çarshisë, meqë këtë projekt e ka konsideruar si të kryer. E, nëse Xhamia nuk arrin të përfundohet as këtë vit, IMMK thotë se vlera prej 95.000 euro me të cilat mund të përfundoj sivjet projekti, vitin tjetër, për shkak të dëmtimeve që mund t'i ketë Xhamia, mund të rritet.

Ndërkohë, Komuna e Prishtinës ka kërkuar nga auditori i brendshëm një raport auditimi rreth të gjitha investimeve të cilat janë bërë deri më tani në Xhaminë e Çarshisë. Sipas tyre, ata tani janë në pritje të këtij raporti, në bazë të së cilit do të planifikojnë hapat në vazhdim për përfundimin e këtij projekti.

Mospërfundimi i restaurimit dhe lënja e objektit në gjendjen aktuale kontribuon në degradimin e tij. Andaj, EC Ma Ndryshe i bën ftesë institucionet relevante që të reagojnë sa më shpejtë për të siguruar mjetet e nevojshme për përfundimin e projektit.

Koordinimi jo i mirë mes institucioneve dhe mungesa e një plani të mirëfilltë dinamik të punëve kanë prodhuar situatën aktuale, të cilën po e vuan Xhamia e Çarshisë dhe jo vetëm. Duke i marrë parasysh këto, EC Ma Ndryshe rekomandon:

- Bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm të mes institucioneve dhe palëve të përfshira në projekt, gjatë të gjitha fazave;
- Planifikim të detajuar të planit dinamik dhe buxhetit;
- Mbikëqyrje të rregullt të punimeve nga profesionistët e fushës.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së komunës së Prishtinës do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prishtinës do të publikohen në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju falemnderit,

arch. Rozafa Basha, koordinatore projekti
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren
Rr. Perandori Dioklecian 14 Kati V (te Qafa), Prishtinë 10000
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771
rozafa.basha@ecmandryshe.org



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.